

**POLITIKA
MBI AKTIVITETET E AKREDITIMIT TË DAK
DHE KRITERET**

DAK-PO-03

APROVUAR NGA,
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Irfan LIPOVICA

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	3
5.1 Aktivitetet dhe kriteret e akreditimit të DAK.....	4
5.2 Zgjerimi i aktiviteteve të akreditimit të DAK	4
5.3 Ndryshimet e kriterëve të akreditimit	5
6. ANEKSET	5
7. REGJISTRAT	5
8. HISTORIA	5

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan politikën e DAK-së lidhur me aktivitetet dhe kriteret e saj të akreditimit. Ai gjithashtu përshkruan mënyrën se si do të bëhen ndryshimet e tyre dhe se si të njëjtat do të komunikohen. Shtojca e dokumentit liston standardet, dokumentet e detyrueshme dhe udhëzuese të DAK, EA, ILAC dhe IAF dhe fushat teknike për ato 4 skema të akreditimit për të cilat DAK aktualisht është duke akredituar.

2. REFERENCAT

- a) Ligji Nr. 05/L-117 për akreditim;
- b) ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i konformitetit - Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat për vlerësimin e konformitetit;
- c) Dokumentet e detyrueshme dhe udhëzuese të EA, ILAC dhe IAF.

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë është e detyrueshme për personelin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së të përfshirë në akreditim (siç janë stafi i brendshëm i DAK, KP, KA, vlerësuesit dhe ekspertët, KT) dhe për klientët e DAK (të akredituar dhe që kërkojnë akreditim).

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj Politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

KA	Këshilli i Akreditimit
TVK	Trupi për vlerësimin e konformitetit
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
IAF	Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit
ILAC	International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve)
KP	Këshilli Profesional
KT	Komiteti Teknik

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

5.1 Aktivitetet dhe kriteret e akreditimit të DAK-së

Sipas nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-117, DAK është e autorizuar të akreditojë:

- a) laboratorët testues dhe kalibrues,
- b) laboratorët mjekësorë,
- c) trupat inspektues;
- d) trupat për certifikimin e produkteve;
- e) trupat certifikues të sistemeve të menaxhimit (cilësisë, ambientit etj.);
- f) trupat certifikues të personelit;
- g) trupat tjerë për vlerësimin e konformitetit.

Në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-117, kriteret e akreditimit bazohen në standardet përkatëse të harmonizuara evropiane dhe standardet ndërkombëtare, si dhe në dokumentet e lëshuara nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare për akreditim.

Aktualisht DAK ofron akreditim në skemat e mëposhtme të akreditimit kundrejt standardit(-eve) të skemës së akreditimit të përmendura:

- a) [laboratorët testues ISO/IEC 17025:2017](#),
- b) [laboratorët kalibrues ISO/IEC 17025:2017](#),
- c) [trupat inspektues ISO/IEC 17020:2012](#),
- d) [laboratorët mjekësor kundrejt 15189:2022](#), përveç testimit në qendrën e kujdesit shëndetësor,
- e) [trupat certifikuese që certifikojnë produkte, procese dhe shërbime sipas ISO/IEC 17065:2012](#).

Kriteret e akreditimit përfshirë standardet e zbatueshme të skemës së akreditimit, dokumentet e detyrueshme dhe udhëzuese të lëshuara nga DAK, EA dhe/ose ILAC dhe fushat teknike janë listuar në Tabelën 1 dhe Tabelën 2 të PO-03-Aneksi 1 dhe janë në dispozicion publikisht në faqen e internetit të DAK-së.

DAK nuk ofron akreditim për fushën fleksibël.

5.2 Zgjerimi i aktiviteteve të akreditimit të DAK

DAK mund të zgjerojë aktivitetet e saj në akreditimin e skemave të reja të akreditimit (p.sh. trupat e certifikimit të sistemit të menaxhimit, trupat e certifikimit të personave, ofruesit e testeve të zotësisë, prodhuesit e materialeve referuese ose organet e tjera të vlerësimit të konformitetit) ose në akreditimin për një skemë të re për vlerësimin e konformitetit nën një skemë ekzistuese të akreditimit në rast se ekziston një nevojë e shprehur nga tregu, një kërkesë e autoriteteve kompetente ose nëse legjislacioni i brendshëm imponon akreditim. DAK zgjeron aktivitetet e saj vetëm në rast se një standard i akreditimit është në fuqi në nivel evropian ose ndërkombëtar. Ky zgjerim i aktiviteteve bëhet sipas politikës së DAK për zhvillimin e skemave të reja të akreditimit (DAK-PO-08).

5.3 Ndryshimet e kriterëve të akreditimit

Kur një standard i skemës së akreditimit rishikohet dhe publikohet, DAK përgatit, në përputhje me politikat e EA/ILAC/IAF, një plan tranzicioni për TVK-të. DAK informon me shkrim secilin TVK të akredituar dhe aplikues mbi planin e tranzicionit dhe e bën atë të disponueshëm publikisht në faqen e saj të internetit. DAK organizon trajnime, brenda periudhës së tranzicionit, për personelin e DAK-së të përfshirë në akreditim në lidhje me ndryshimet. Për më tepër, DAK mund të organizojë trajnime të përgjithshme për TVK-të për të ofruar informacione mbi ndryshimet.

Kur EA dhe/ose ILAC/IAF publikojnë një dokument të ri ose të rishikuar të detyrueshëm, atëherë DAK e bën atë të disponueshëm publikisht në faqen e saj të internetit dhe informon TVK-n përkatëse me shkrim për datën e zbatimit të dokumentit në përputhje me periudhën e tranzicionit të deklaruar në dokument. DAK organizon trajnime, brenda periudhës së tranzicionit, për personelin e DAK-së të përfshirë në akreditim në lidhje me dokumentin e ri ose të rishikuar të detyrueshëm.

6. ANEKSET

PO-03-Aneksi 1 Kriteret e Akreditimit dhe fushat teknike

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
02.12.2015	Ibush Luzha	Dokument i ri.
11.03.2016	Ibush Luzha	Kapitulli 3.1 është modifikuar në mënyrë që të përfshijë në kriteret e akreditimit dokumentet e detyrueshme të DAK. Ndryshimet janë të paraqitura me shkronja të kaltra.
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01
19.05.2021	Valmira Sejdiu	Rishikim në përputhje me DAK-PM-01
25.02.2026	Valmira Sejdiu	Rishikim në përputhje me DAK-PM-01